



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 125, datë 27.10.2022

PËR

MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË RINDËRTIMIT TË PËRFITUAR NË ZBATIM TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 597, DATË 14.9.2022 “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, DHE SHKËMBIMIN E PRONËS, NË FUNKSION TË PROÇESIT TË RINDËRTIMIT NË ZONËN E PLANIFIKUAR PËR RINDËRTIM, SIPAS PLANIT TË DETYRUAR VENDOR PËR ZONËN E DËMTUAR PIKËSORE PËR 5 BANESA KOLEKTIVE, NË BASHKINË DURRËS”

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, të ndryshuar, Aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Vendimit nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 6.1.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, Vendimit nr. 7, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për kushtet dhe procedurat për shpronësimet dhe/ose shkëmbimin e pronës, për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit”, të ndryshuar, Vendimit nr. 8, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje”, të ndryshuar, Vendimit nr. 597, datë 14.9.2022 “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, dhe shkëmbimin e pronës, në funksion të procesit të rindërtimit në zonën e planifikuar për rindërtim, sipas planit të detyruar vendor për zonën e dëmtuar pikësore

për 5 banesa kolektive, në bashkinë Durrës”, si dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e përdorimit të fondit të rindërtimit prej 7 270 855 (shtatë milionë e dyqind e shtatëdhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë alokuar në formën e transfertës së pakushtëzuar në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 597, datë 14.9.2022 “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, dhe shkëmbimin e pronës, në funksion të procesit të rindërtimit në zonën e planifikuar për rindërtim, sipas planit të detyruar vendor për zonën e dëmtuar pikësore për 5 banesa kolektive, në Bashkinë Durrës” sipas tabelës 1, bashkëlidhur si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 28.10.2022

LISTA E PERSONAVE QË SHPRONËSOHEN SIPAS VKM NR. 597 DT. 14.09.2022

Tabela 1

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. i pas.	Vol	Faqe	Indeksi i hartës	Dokumenti i pronësisë	Lloji i pasurisë	Sip. Total e ref. (m2)	Shpronësim tokë "truall"				Ndërtesë banimi (shtëpi)				Përlogaritja e masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen	Vlera totale për shpronësim	
												Sip. Truall konf. Nga ASH K DV Durrës (m2)	Sip. për shpronësim sipas planit të shpronësimit - ndërtesat kolektive (m2)	Sip. totale për shpronësim (m2)	Çmimi (lekë/m2) sipas VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016	Vlera (lekë)	Sip. ndërt konf. nga ASH K DV Durrës (m2)	Sip. për shpronësim sipas planit të shpronësimit - ndërtesa kolektive (m2)	Sip. totale për shpronësim (m2)			Çmimi sipas shprehës së ASHK DV Durrës, nr. 1496/1, atë 28.3.2022
1	VIOLETA	RAMIZ	BAKALLI	8513	5/672	Kodi: 8513050220	DR-H16.7	kantieri Pasurisë së Paluajtshme	TRUALL	89.00	89.00	89.00	89.00	12,945	1,152,105	89.00	89.00	89.00	68,750	6,118,750	7,270,855	7,270,855





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 834/prot.
16

Durrës, më 08.11.2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.125 datë 27.10.2022 “Për miratimin e përdorimit të fondit të rindërtimit të përfituar në zbatim të VKM nr 597 dt 14.09.2022 “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtëshe, pronë private dhe shkëmbimin e pronës në funksion të procesit të rindërtimit në zonën e planifikuar për ndërtiom, sipas planit të detyruar vendor për zonën e dëmtuar pikësoreë për pesë banesa kolektive, në Bashkinë Durrës”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

